


# Myku në hapësira banimi

Informacione për banorë, qiramarrës dhe qiradhënës





Schweizerische Eidgenossenschaft  
Confédération suisse  
Confederazione Svizzera  
Confederaziun svizra

Swiss Confederation

Federal Department of Home Affairs FDHA  
**Federal Office of Public Health FOPH**





## **Rreth nesh**

Teksti: Claudia Vassella Brantschen, Dr. Phil.

Fotot: 1–2, 4–11: Belfor (Suisse) AG, Foto 3: T. Ammann, Foto 12: B. Habegger

Redaktimi: © Federal Office of Public Health (Zyra Federale e Shëndetësisë), korrik 2010

Kjo broshurë e pasqyron gjendjen ndërkombëtare të njohurive. E fundit nga radha por jo nga rëndësia, ajo është në përputhje me kërkesat e Organizatës Botërore të Shëndetësisë – OBSH.

### **Me përhapje të gjerë**

Ndoshta edhe ju jeni të prekur? Problemet me lagështi dhe myk shfaqen në një të katërtën apo të pestën e shtëpive prandaj këto nuk janë aspak raste të rralla.

### **Një dyshe e pandarë**

Nëse materialet janë të lagura për ditë të tëra, ka gjasa të mëdha që të formohet myk. Në anën tjetër, myku nuk formohet pa pasur lagështi.

### **Lagështia e dëmshme**

Me përhapjen e mykut, rritet edhe rreziku i shëndetit. Përveç pezmatimit të syve, lëkurës dhe sistemit të frymëmarrjes, herë pas here mund të ndodhin edhe alergjitë e ndryshme. Me kalim të kohës këto pezmatime të sistemit të frymëmarrjes mund të kalojnë në bronkit kronik (kollitje) dhe astmë. Për shkak të erës së tij të keqe e të theksuar, myku mund të ndikon edhe në mirëqenien e njeriut. Bile dyshohet se ai mund të jetë udhëçelës i ftohjeve. Nëse njeriu vuan nga ndonjë sëmundje e mëparshme, atëherë myku shkakton rreziqe shtesë: kështu, te rastet me astmë të rëndë kronike apo fibrozë cistike (FC) rritet rreziku për sëmundje të rrezikshme

alergjike të mushkërive (Aspergjilozja Bronkopulmonale alergjike – ABPA). Veç kësaj, pacientët që janë me një sistem të dobësuar imunitar (ata me SIDA dhe me kancer) mund të sëmuren nga infeksionet bakteriale dhe ato fungale që janë të rrezikshme për jetën. Megjithatë, këto infeksione të brendshme nuk përbëjnë problem te njerëzit e shëndetshëm.

### **Çfarë duhet bërë tani? – Është lehtë të veprohet siç duhet**

Si duhet të veprosh ti si qiraxhi, pronar apo si administrator i objekteve të banimit, me mykun që formohet? A kemi të bëjmë me diçka të parëndësishme apo me një problem serioz? Tabelat vijuese do t'ju ndihmojnë të merrni vendime të drejta.

Tabelat u korrespondojnë llojeve të ndryshme të mykut. Cilës kategori i përket situata suaj? Krahasoni fotografitë e tabelës me situatën tuaj. Pastaj lexoni shenjat e dëmtimit për ta përcaktuar kategorinë. Nëse e vetmja shenjë paralajmëruese është era e mykut, atëherë situata juaj do të përshkruhet në tabelën e katërt.




# Formimi i mykut në dhomat e ditës dhe ato të banimit

(duke përfshirë banjën, kuzhinën dhe korridorin)

Kat.	Shenjat e dëmtimit	Vlerësimi i përafërt i dëmit strukturor dhe rreziku për shëndetin	Rekomandimet për qiramarrësit
0	<p>Gjurmë të formimit sipërfaqësor të mykut me një shtrirje deri në 100 cm<sup>2</sup> (d. m. th. 10 × 10 cm) në një vend, vetëm në një dhomë.</p> <p>Nuk disponohen prova që mund të tregojnë për ndonjë problem më të madh.</p>	Pa ndonjë problem fizik dhe shëndetësor	<p><b>Nuk ka arsye për t'u shqetësuar</b></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Raportoju qiradhënësit problemet me lagështirën dhe mykun.</li><li>– Gjurmët e mykut mund të hiqen lehtë me ujë dhe detergjent komercial pa ndonjë shqetësim për shëndetin tuaj. Pastaj, nëse është e nevojshme, ju mund ta dezinfektoni vendin me ujë Javel (tretësirë ujore hipoklorite) apo me alkool etilik 70–80 %.</li><li>– Nëse gjurmët e mykut nuk janë pastruar siç duhet, atëherë duhet t'i mbani nën vëzhgim ato dhe në një periudhë më të vonshme kohore ta bëni vlerësimin përsëri.</li><li>– Problemet e mundshme shëndetësore nuk lidhen me gjurmë të vogla dhe sipërfaqësore të mykut. Megjithatë, është mirë që këto gjëra të sqarohen me mjekun.</li></ul> <p><b>Rekomandimet për qiradhënësit / pronarët</b></p> <p>Për një eliminim afatgjatë të gjurmëve të mykut, ju duhet së pari ta qartësoni dhe ta zgjidhni shkakun e shtimit të lagështisë (për informacione mbi sqarimin e dëmeve, shikoni adresat e shënuara më poshtë).</p>



Foto 1–4





Kat.	Shenjat e dëmtimit	Vlerësimi i përafërt i dëmit strukturor dhe rrezikut për shëndetin	Rekomandimet për qiramarrësit
1	<p>Formimi sipërfaqësor i mykut apo njollave të mykut në një vend, vetëm në një dhomë:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Formim i veçantë deri në 0.5 m<sup>2</sup> (dmth. 70 × 70 cm)</li><li>– Te një formim më i dendur deri në 100 cm<sup>2</sup> (d. m. th. 10 × 10 cm)</li></ul> <p>Nuk disponohen prova që mund të tregojnë për ndonjë problem më të madh.</p>	<p>Për sa i përket aspektit të kujdesit shëndetësor, kjo situatë është e papranueshme.</p> <p>Situata nuk është edhe aq problematike parë aspektin fiziko-strukturor. Por gjendja mund të përkeqësohet.</p>	<p>– Raportoju problemet me mykun dhe lagështirën menjëherë te qiradhënësi juaj apo administratori i pronës. Përndryshe ju do të jeni përgjegjës për dëmet që mund të shkaktohen. Më e mira është që dëmi të përshkruhet apo të fotografohet dhe pastaj letra të dërgohet me postë rekomande. Për ta hetuar çështjen më tej është përgjegjës qiradhënësi apo administratori i objektit të banimit.</p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Asnjëherë mos të futen në përdorim aparatet për heqje të lagështisë para se të bëhet eliminimi i mykut.</li><li>– Bëni ajrosje të shpeshtë të dhomave.</li><li>– Personat e rrezikuar* duhet së pari të kontaktojnë me mjekun e tyre sa i përket mykut dhe korrigjimit e kurimit të domosdoshëm.</li></ul> <p><b>Rekomandimet për qiradhënësit / pronarët</b></p> <p><i>Planifikoni një korrigjim e kurim profesional. Ai përfshin:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Mënjanimin dhe sqarimin e shtimit të lagështirës e më këtë edhe të formimit të mykut apo së paku marrja e masave përmirësuese (për informacione mbi sqarimin e dëmeve, shihni adresat e shënuara më poshtë).</li><li>– Pastrimin e plotë të formimit të mykut si dhe tharjen e materialeve të njoma dhe të pastruara.</li></ul> <p><i>Me këtë rast ju duhet të kini parasysht këto gjëra:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>– Mos kryeni asnjë korrigjim e kurim në prani të personave të rrezikuar*! Për këtë korrigjim e kurim drejtoju korrigjuesve e kuruesve profesionistë (për informacione shikoni adresat).</li><li>– Përndryshe ose largojeni vetë mykun sipas përshkrimeve të broshurës «Kujdes Myku» ose drejtoju ndonjë firmë me kompetencë për eliminimin e plotë dhe profesional (për informacione mbi korrigjimin e kurimin, shikoni adresat).</li><li>– Asnjëherë të mos futen në përdorim aparatet për heqje të lagështisë para se të bëhet eliminimi i mykut.</li></ul> <p>* Personat e rrezikuar: Pacientët me fibrozë cistike (FC) dhe astmë të rëndë alergjike, si dhe në veçanti pacientët me sistem të dobësuar imunitar si p.sh. pacientët që kanë bërë transplantime, personat me SIDA si dhe ata me kancer.</p>



Foto 5–8

# Formimi i mykut në dhomat e ditës dhe ato të banimit

(duke përfshirë banjën, kuzhinën dhe korridorin)

Kat.	Shenjat e dëmtimit	Vlerësimi i përafërt i dëmit strukturor dhe rrezikut për shëndetin	Rekomandimet për qiramarrësit
2	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Formimi i veçantë i mykut apo njollave të e veçanta të mykut në një hapësirë prej mbi 0.5 m<sup>2</sup> (d. m. th. 70 × 70 cm) apo:</li> <li>– Formim më i dendur dhe gjithëpërfshirës i mykut në një sipërfaqe mbi 100 cm<sup>2</sup> (d. m. th. 10 × 10 cm) apo:</li> <li>– Formimi i mykut në shtresat më të ulëta apo:</li> <li>– Formimi i mykut apo i njollave të mykut në shumë vende të së njëjtës dhomë apo në dhoma të ndryshme</li> </ul>	<p>Për a i përket aspektit të kujdesit shëndetësor, kjo situatë është e papranueshme.</p> <p>Situata është shpesh problematike duke parë aspektin fiziko-strukturor. Gjendja mund të përkeqësohet edhe më tej.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Raportojini problemet me mykun dhe lagështirën menjëherë te qiradhënësi juaj apo administratori i pronës. Përndryshe ju do të jeni përgjegjës për dëmet që mund të shkaktohen. Më e mira është që dëmi të përshkruhet apo të fotografohet dhe pastaj letra të dërgohet me postë rekomande. Për ta hetuar çështjen më tej është përgjegjës qiradhënësi apo administratori i objektit të banimit.</li> <li>– Problemet e mundshme shëndetësore duhet sqaruar me mjekun. Personat e rrezikuar* për shkak të rrezikut të lartë duhet sa më shpejt të kontaktojnë me mjekun e tyre.</li> <li>– Në krahasim me dhomat e tjera, dhomat që kanë formim intensiv të mykut duhen mbajtur të mbyllura dhe si masë paraprake të mos përdorën fare. Kujdes i veçantë duhet treguar te dhomat e fjetjes dhe ato të fëmijëve.</li> <li>– Bëni ajrosje të shpeshtë të dhomave.</li> <li>– Asnjëherë të mos futen në përdorim aparatet për heqje të lagështisë para se të bëhet eliminimi i mykut.</li> </ul> <p>* Personat e rrezikuar: Pacientët me fibrozë cistike (FC) dhe astmë të rëndë alergjike, si dhe në veçanti pacientët me sistem të dobësuar imunitar si p.sh pacientët që kanë bërë transplantime, personat me SIDA si dhe ata me kancer.</p>







Foto 9–12



## Rekomandimet për qiradhënësit / pronarët

- Kërkoni menjëherë një sqarim për shkallën dhe shkakun e dëmit nga një specialist i dëmtimeve dhe fizikës ndërtimore. Këto sqarime (hetime) mund të ndërmerren nga ana e kompanisë që ju dëshironi ta angazhoni për korrigjimin e kurimin. Si kusht paraprak duhet të jetë përvoja me korrigjime e kurime të mëdha si dhe metoda profesionale e punës së tyre (për informacione mbi korrigjimin e kurimin, shikoni adresat). Mos i kryeni vetë korrigjimet e kurimet! Shkaqet e një lagështie të lartë duhet të eliminohen në mënyrë të përhershme.
- Asnjëherë të mos futen në përdorim aparatet për heqje të lagështisë para se të bëhet eliminimi i mykut.
- Pas ndreqjes së problemit të mykut, këshillohet që banorët të informohen në mënyrë objektive pa ndonjë akuzim për sjellje të papërshtatshme (shikoni më poshtë «Nuk do të ketë kurrë (më) formim të mykut»).



## Kundërmim myku pa ndonjë myk të dallueshëm

Shenja paralajmëruese	Paralajmërimet për dëme strukturore dhe rrezik për shëndetin	Rekomandimet për qiramarrësit
<p>Kundërmim i qartë dhe i dallueshëm myku</p>	<p>Kundërmimi i qartë dhe i dallueshëm i mykut pa ndonjë myk të dallueshëm është një shenjë paralajmëruese për formim të fshehtë të mykut.</p> <p>Kjo situatë duhet të sqarohet nga aspekti i kujdesit shëndetësor.</p> <p>Rekomandohet një sqarim edhe për shkaqe fiziko-strukturore.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>– Raportojini problemet me mykun dhe lagështirën menjëherë te qiradhënësi juaj apo administratori i pronës. Përndryshe ju do të jeni përgjegjës për dëmet që mund të shkaktohen. Më e mira është që dëmi të përshkruhet apo të fotografohet dhe pastaj letra të dërgohet me postë rekomande. Për ta hetuar çështjen më tej është përgjegjës qiradhënësi apo administratori i objektit të banimit.</li> <li>– Personat e rrezikuar* për shkak të rrezikut të lartë duhet sa më shpejt të kontaktojnë me mjekun e tyre.</li> </ul> <p>* Personat e rrezikuar: Pacientët me fibrozë cistike (FC) dhe astmë të rëndë alergjike, si dhe sidomos pacientët me sistem të dobësuar imunitar si p.sh pacientët që kanë bërë transplantim, personat me SIDA si dhe ata me kancer</p> <p><b>Rekomandimet për qiradhënësit</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>– Perceptimi i aromës mund të ndryshojë shumë dhe varet nga individi në veçanti. Si hap i parë duhet të konfirmohet era e keqe për të cilën edhe ankohemi: A nuhatet kjo erë e mykut në mënyrë të qartë dhe të dukshme edhe nga të tjerët?</li> <li>– Nëse në atë vendbanim ka njerëz që nuk e ndjejnë veten mirë apo ka persona të rrezikuar, ju duhet të hiqni dorë nga vetë-hulumtimi e sidomos nga largimi i pjesëve ndërtimore. Në këtë rast angazhoni ndonjë specialist të dëmeve ndërtimore dhe fizike që t'i hulumtojë shkaqet e dëmit. Atij duhet njoftuar se aty ka persona të ndjeshëm. Pasi të gjendet vendi i formimit të mykut, ju duhet të planifikoni një korrigjim e kurim profesional duke e përfshirë edhe eliminimin e shkaqeve. Mos e kryeni vetë korrigjimin e kurimin! (për informacione mbi korrigjimin e kurimin dhe sqarimin e dëmeve, shihni adresat).</li> <li>– Në qoftë se aty ka vetëm njerëz të shëndetshëm, atëherë ju si pronar, mund t'i kërkonti vetë dëmet e dyshuara nga lagështia. Megjithatë, edhe pse mund të ketë argumente për myk të konsiderueshëm ju nuk duhet t'i largoni produktet ndërtimore, pasi në këto raste kërkohet korrigjim e kurim nga stafi profesional. Ata i dinë metodat për kërkim të dëmeve nga lagështia pa shkakuar dëme të tjera. Në rast se ato dëme janë të pranishme, menjëherë duhet eliminuar dhe sqaruar shkaku i tyre. Dëmtimet e kategorisë 1 mund t'i largoni vetë në bazë të broshurës «Kujdes Myku», ndërsa ato të kategorisë 2 duhet të eliminohen plotësisht dhe në mënyrë të saktë nga një kompani me përvojë (për informacione shihni adresat).</li> <li>– Matja e ajrit të dhomës me MVOC kryesisht nuk ndihmon edhe aq shumë: pasi ajo as nuk është as e besueshme e as e dobishme.</li> </ul>



## SHEMBUJ







**Në shtëpinë që e kanë marrë me qira Dorisi dhe burri i saj, disa mure janë të njoma dhe në to formohet myk. «Do të doja ta bëja matjen e ajrit në shtëpi dhe të merrja një vlerësim mbi gjendjen e mureve. Kujt mund t'i drejtohem?», i shkruan ajo BAG-ut.**

Së pari, Dorisi dhe burri i saj duhet të kontaktojnë qiradhënësin dhe ta njoftojnë mbi problemin e lagështisë dhe mykut. Mjafton një përskrim i dëmit me shkrim dhe një fotografi. Më pas përgjegjësia për korrigjimin e kurimin kalon te qiradhënësi. Këtu nuk ka nevojë për ndonjë vlerësim apo matje të ajrit të dhomës. Matjet vetëm sa do t'i vërtetojnë asaj atë që është e dukshme: formimin e mykut, i cili duhet të eliminohet për arsye shëndetësore.



**Ralfi dhe qiradhënësi i banesës së tij nuk pajtohen mbi arsyen e formimit të mykut në dy skajet e dhomës. Ralfi i drejtohet BAG-ut, për të zgjidhur ngërçin e krijuar.**

Qiradhënësi i Ralfit duhet të marrë një specialist për dëmtime strukturore dhe fizike për të gjetur arsyen. Sepse, për të bërë korrigjimin e kurimin e duhur atij i duhet të dijë shkaqet. Nëse Ralfi dhe qiradhënësi i tij nuk arrijnë të pajtohen edhe pas një sqarimi serioz të shkakut, ata mund t'i drejtohen Komisionit të Konfliktëve. Procedura është falas. Gjatë periudhës përgatitore, Ralfi mund të këshillohet me shoqatën e qiraxhinjve ndërsa qiradhënësi i tij me shoqatën e pronarëve të shtëpive. BAG-u megjithatë, nuk mund ta ndihmojë konkretisht Ralfin.



## Zbulimi i shkaqeve

Asnjë korrigjim e kurim nuk mund të sjellë ndonjë rezultat të kënaqshëm, nëse nuk sqarohet dhe mënjanohet, apo së paku neutralizohet, shkaku i një lagështie të tepruar. Një ndër shkaqet më të shpeshta janë muret e jashtme të keqizoluara. Gjatë stinëve të ftohta të vitit, ato ftohen dhe prandaj mbeten të njoma. Si rezultat vjen zhvillimi i mykut në muret e jashtme si dhe në skajet e tyre. Temperatura e ulët e dhomës, vetëm sa e përkeqëson këtë situatë jo të favorshme.

Megjithatë, edhe në kushte optimale shfaqet mjaft lagështi kur ne bëjmë dush, banjë apo gatuajmë. Në qoftë se ajo lagështi vazhdon për një kohë të gjatë dhe nuk zhduket plotësisht, atëherë do të formohet myku dhe fillimisht në vende të ftohta si dritare, korniza dritarësh dhe në muret e jashtme. Nuk janë gjithmonë fajtorë banorët për ajrosje të pamjaftueshme: shkak për një ajrosje të pamjaftueshme mund të jetë edhe ndonjë aspirator me defekt, ventilator i ndotur i sobës, dritare shumë të vogla, apo dritaret që hapen vetëm në mënyrë të pjerrët.

Ndodhë shumë rrallë që uji nga jashtë të depërtojë në ndërtesë duke bërë që të shkaktohen dëme të shpeshta dhe kërcënuese të lagështisë. Shkaktarë mund të jenë edhe shiu i furishëm, plasaritjet, mbulimi i dëmtuar i kulmit, kullimi i pamjaftueshëm, rrjedhja e gypave apo lagështia e tepruar e tokës.


## Këshilla juridike falas për qiramarrës dhe qiradhënës

Mosmarrëveshjet shpesh mund të evitohen nëse shkaqet sqarohen nga një specialist i pavarur. Në rast të kundërt, këshilla falas mund të merrni pranë Komisioneve të Konfliktëve / Zyrave e qiradhënies, shoqatat e qiramarrësve apo pronarëve të shtëpive (vetëm për anëtarët e tyre). Merni parasysh këtë sqarim të specializuar pa rrezikuar lidhjen reciproke qiramarrës-qiradhënës sipas hamendjeve personale (Shihni listën e adresave / Pyetje mbi ligjin e qiramarrësve dhe qiradhënësve).

## Korrigjimi e kurimi: Vetëm korrigjimi e kurimi profesional është i arsyeshëm

Nëse korrigjimi e kurimi nuk bëhet në kohë, atëherë shpenzimet për të do të jenë më të mëdha. Megjithatë, korrigjimi dhe kurimi i kërpudhave të mykut nuk është vetëm i panevojshëm, por është edhe masë ekstreme sepse ekspozimi ndaj komponentëve fungalë gjatë korrigjimit e kurimit mund të rritet nga 1000 në 10 000 fish. Shëndetin mund ta dëmtojnë si pluhuri ashtu edhe substancat kimike. Për të mos u rrezikuar as korrigjuesi e as banorët, korrigjimi e kurimi i mykut duhet zbatuar sipas buletineve të Suva dhe të Shoqatës Zvicerane të Suvatuesve dhe Bojaxhinjve (SMGV). Varësisht se sa serioze është situata, korrigjuesit duhet të pajisen me rroba pune, dorëza mbrojtëse, maska mbrojtëse si dhe syza mbrojtëse. Në raste të tjera është e nevojshme mbyllja e vendeve të korrigjimit e kurimit kundrejt dhomave të tjera apo edhe përkujdesja për hyrje të ajrit të pastër si dhe për vakum në hapësirën që do të korrigohet e kurohet. Pjesët e kërpudhave duhet të eliminohen gjithmonë plotësisht, të bëhet tharja e vendeve të njoma si dhe të eliminohen apo neutralizohen shkaqet e lagështisë së tepruar.

Para përdorimit të bojërave të brendshme biocide dhe veshjes me suva të dhomave të ndenjes dhe ato të ditës, së pari këshillohuni me BAG (Zyrën Federale të Shëndetit Publik) dhe shoqatat SMGV (Shoqatat Zvicerane të Suvatuesve dhe Bojaxhinjve) si dhe VSLF (Shoqatën e Industrisë së Llakut dhe të Ngjyrave), pasi që është e vështirë të parashikohen rreziqet afatgjata te banorët. Sidoqoftë, amatorët që përdorin mjete kundër mykut, duhet t'i kushtojnë vëmendje shënimeve në paketim dhe ta mbrojnë veten me syza mbrojtëse, maskë mbrojtëse si dhe rroba pune me mëngë të gjata. Mjetet kundër mykut nuk mund ta zëvendësojnë korrigjimin e kurimin e tij.



## Nuk do të ketë kurrë (më) formim të mykut

Të interesuarit do të gjejnë në broshurën «Kujdes Myku» një kapitull të tërë mbi temën se si të parandalohet formimi i mykut. Rekomandimet vijuese janë nga kjo broshurë:

### Rekomandimi i BAG-ut mbi lagështinë e ajrit të dhomës

Si rregull të përgjithshëm, BAG-u rekomandon që në periudhën e nxehtë të ketë një lagështi relative të ajrit të dhomës nga 30–50%. Ndërsa në ditët shumë të ftohta, ajo nuk duhet të jetë më e lartë se 40%. Lagështia e ajrit mund të ulet nëse ne i ajrosim më shpesh dhomat duke pasur kështu më pak lagështi.

### Në veçanti duhen pasur kujdes apartamentet kritike me paraqitje të dobët të lagështisë

Shmangni tharjen e rrobave apo përdorimin e aparateve për njomje në hapësirat banuese që kanë probleme me lagështirë.

### Ajrosja e duhur

Si rregull i përgjithshëm: ajrosini ambientet duke hapur të të gjitha dyert dhe dritaret për 5 deri 10 minuta të paktën 3 herë në ditë. Ata të cilët gjatë ditës nuk janë në shtëpi, mund ta bënë këtë në mëngjes, kur të kthehen në shtëpi dhe para gjumit. Ajrosja mundësisht duhet bërë edhe më shpesh në ndërtesat e vjetra, me dritare të reja por me izolim të dobët termik. E njëjta gjë vlen edhe për vendbanimet ku shumë persona jetojnë në një hapësirë të vogël si dhe për ndërtesat e reja apo ndërtesat pas rinovimeve të mëdha. Duhet shmangur ajrosjet konstante të hapësirave me dritare të hapura në mënyrë të pjerrët, gjatë stinës së nxehtë.

Gjatë gatimit, dushit, banjës apo hekurosjes, duhet ajrosur apo aktivizuar menjëherë ventilatori ajrues nëse pason shumë avull. Pajisjet e dëmtuara të ajrosjes duhen riparuar menjëherë si dhe rregullisht të pastrohen ventilatorët e sobës në kuzhinë. Dritaret e veshura me avull janë shenjë e qartë e lagështisë së lartë.



**Etienne që prej një viti është pronar e një banese të vjetër. Disa muaj më parë, u shfaqën disa njolla në muret e dhomës së fëmijëve. Gjatë dy javëve të fundit në një sipërfaqe prej rreth gjysmë metri katror është shfaqur një myk i dukshëm. Etienne është në dijeni të një problemi të mëparshëm me lagështinë dhe është e shqetësuar se këtij muri të lagur i është dhënë vetëm një shtresë boje.**

Më e mira është që Etienne ta raportojnë dëmin tek administratori i pallatit. Pastaj shkallën dhe shkahun e dëmtimit duhet ta sqarojë një profesionist i dëmeve strukturore dhe fizike. Mbi këtë bazë, me ndihmën e rregulloreve të shoqatës për bashkëpronësi të ndërtesave mbetet për t'u vendosur nëse përgjegjës është Etienne apo komuna për riparimin e dëmit ose eliminimin e shkaqeve. Sidomos në shtëpi të vjetra, të izoluar keq dhe me një problem të fshehur të mykut, është e kuptueshme që në momente të tilla të zbatohet një korrigjim e kurim i përgjithshëm i fasadës. Aty nuk është bërë një korrigjim e kurim profesional sepse dëmet e lagështisë janë mbuluar me një shtresë të hollë me bojë kundër mykut. Por, lagështia dhe komponentët përbërës të mykut janë ende të pranishëm. Pikërisht për këtë, duhet sqaruar shkaku i lagështisë së lartë si dhe të bëhet mënjanimi i saj. Pastaj myku do duhej plotësisht eliminuar sipas udhëzimeve të fletëpalosjes së Suva, të bëhet tharja e plotë e mureve dhe rregullimi i konstruksionit të murit.





**Në shtëpinë e Manuelës në çdo dhomë janë mykur fugat e dritareve. Për këtë arsye qiradhënësja do dëshironte që në ato dritare të vendoseshin fuga të reja. «Mos ndoshta kemi shëndetin në rrezik këtu?», dëshiron të dijë Manuela nga BAG-u.**

Manuela nuk ka arsye për t'u shqetësuar: Përderisa myku është i kufizuar vetëm në fugat e dritareve, kjo zonë është e vogël dhe jo-problematiche. Edhe zëvendësimi i fugave nuk paraqet asnjë problem. Duke qenë se nga myku nuk është prekur vetëm banja por të gjitha dhomat, për qiradhënësin është një punë pak më e ndërlikuar. Është mirë që ai të kërkojë ndihmë nga një profesionist i dëmeve strukturore dhe fizike për të kuptuar arsyet e kësaj rritjeje të mykut. Në qoftë se dritaret janë të ftohta, atëherë është më mirë të ndërrohen dritaret sesa të bëhet zëvendësimi i fugave. Por në qoftë se ngarkesa e lagështisë është e lartë në të tërë shtëpinë, atëherë së pari duhet bërë reduktimi i saj. Në këtë rast duhet marrë në konsideratë mundësia që qiramarrësi ta bënte ajrosjen më të shpeshtë të dhomave për të prodhuar më pak lagështi. Duhet verifikuar gjithashtu nëse mundësitë ekzistuese për ajrosje u përshtaten standardeve (SIA 180, SIA 382/1, shihni gjithashtu SIA 2023).

### **Ngrohja e duhur**

Veçanërisht të ndjeshme janë ndërtesat e vjetra të viteve '60 dhe '70 (me mure të ftohta dhe të izoluara keq). Atje nuk duhet vonuar fillimi i ngrohjes, por temperatura e dhomave duhet të rregullohet në 20 °C. Ndërsa në ndërtesat e ajrosura dhe të izoluara mirë, nuk është aspak problematike rënia e temperaturës së dhomës, p.sh. në 18 °C në dhomat e fjetjes.

### **Mobilimi i duhur**

Perdet dhe orenditë mund të pengojnë qarkullimin e ajrit dhe të nxisin rritjen e mykut. Për këtë arsye rekomandohet që mes mobileve dhe mureve të jashtme të ketë një distancë prej 10 centimetrash. Gjithashtu edhe ormanët dhe vitrinat e mëdha nuk duhet të mbështeten në muret e jashtme të ftohta apo në skajet e mureve të jashtme. Në qoftë se kornizat e dritareve janë të ftohta, atëherë është më mirë të mos vendosen perde.

### **Korrigjimi e kurimi i duhur dhe sipas rregullit**

Para se të bëhet *korrigjimi e kurimi i dritareve* apo të ndërmerret ndonjë masë tjetër izoluese, rekomandohet që situata së pari të vlerësohet nga ndonjë arkitekt apo inxhinier i sistemeve të ajrimit. Në këtë rast së pari duhet vlerësuar rreziku i dëmtimit të pjesëve të ndërtimit (urat termike) si dhe të kontrollohet sistemi i ajrosjes. Nëse ekzistojnë pajisjet për ajrosje atëherë gjithashtu duhet vlerësuar mundësia e futjes së ajrit shtesë. Vetëm atëherë mund të jemi të sigurt se nuk do të formohet myk pas një apo dy viteve.

*Armaturat izoluese higjienike duhet të zëvendësohen me kalimin e kohës:* Pas disa viteve, armaturat izoluese do ta humbin elasticitetin dhe tkurren e tyre. Fillimisht ato do të prishen në anët e vaskave të dushit dhe të banjës e pastaj uji do të depërtojë në shtresat më të thella.



## Informacione shtesë

Broshura «Kujdes Myku» është krijuar nga sponsorizimi i përbashkët i BAG, HEV, MV dhe SVIT. Përveç informacioneve të detajuara mbi temat e trajtuara në këtë broshurë ju do të gjeni edhe udhëzime të hollësishme si ta bëni vetë korrigjimin e kurimin.


– Shkarkoni: [www.wohngifte.admin.ch](http://www.wohngifte.admin.ch) > gesund wohnen > Feuchtigkeitsprobleme und Schimmel

Fletëpalosje mbi korrigjimin e kurimin e mykut nga Suva dhe SMGV do t'i gjeni në [www.suva.ch/waswo](http://www.suva.ch/waswo) dhe në [www.malergipser.com](http://www.malergipser.com)



**Maria është një person i lumtur dhe me pikëpamje pozitive. Që nga fëmijëria ajo vuan nga një astmë e rëndë alergjike. Por ajo është mësuar me këtë gjë. Disa muaj më parë ajo është sëmur rëndë dhe ka marrë një diagnozë serioze nga ABPA: Si pasojë, Maria vuan nga një sëmundje alergjike e mushkërive nga kërpudhat e mykut *Aspergillus fumigatus*. Mjeku e ka këshilluar atë se gjatë kësaj sëmundjeje është shumë më rëndësi mos-kontakti me këtë lloj kërpudhe. Maria u drejtua BAG-ut me pyetje se si ajo mund ta realizojë këtë gjë.**

Ne i kemi rekomanduar Maries broshurën «Kujdes Myku». Ajo duhet t'i njohë tiparet e kërpudhave të mykut e sidomos të llojit *A. fumigatus*, për të ditur se ku mund të gjendet ai. Banesa e saj duhet të jetë patjetër e thatë. Në asnjë rrethanë, Maria nuk duhet të jetojë në një banesë ku ka formim të mykut dhe as në banesa ku bëhet korrigjimi dhe kurimi i mykut. Ajo duhet të heqë dorë edhe nga bimët shtëpiake si dhe nga mbledhja me grabujë e gjetheve, kositja e barit dhe punë të ndryshme në kopsht. Për më tepër Maria duhet të mos shëtisë dhe ecë nëpër gjethe. Ajo nuk duhet ta plehërojë kopshtin e saj me pleh të kompostuar dhe në asnjë rast në banesën e saj nuk duhet të grumbullohen mbeturina organike.



## Adresat tjera kryesore

### Pyetje mbi ligjin e qiramarrjes

#### Shoqata Zvicerane e Qiraxhinjve (MV / ASLOCA / ASI)

Sektor i Deutschs Schweiz, [www.mieterverband.ch](http://www.mieterverband.ch)  
Tel.: 043 243 40 40 apo MV-linja telefonike për konsultime mbi ligjin e qiramarrjes: 0900 900 800 (CHF 3.70 për minutë, shërbim nga linja fikse). Këshillimi ligjor falas për anëtarët. Ofrohet edhe një konsultim me pagesë për defektet në apartament.

#### Shoqata Zvicerane e Pronarëve të Shtëpive (HEV / APF)

<http://hev-schweiz.ch/2929.0.htm>. Për numrat e telefonave të sektorëve rajonalë shihni në librin e telefonave apo në faqen e internetit të HEV. Këshillimi ligjor falas për anëtarët.

#### Shoqata Zvicerane e Shtëpive (HVS)

[www.hausverein.ch](http://www.hausverein.ch), Tel. 031 311 50 55 . Këshillimi ligjor falas për anëtarët.

#### Komisionet e Konflikteve / Zyrat e qiradhënies

Këto organe rajonale i këshillojnë falas qiramarrësit dhe qiradhënësit në çështjet që kanë të bëjnë me qiranë si dhe i gjykojnë mosmarrëveshjet gjatë kontestimeve përmes arbitrazhit.

Adresa: Kontaktoni administratën tuaj komunale apo sektorin rajonal të HEV apo MV (shihni më lart).

### Këshilla nga agjencitë e pronave të patundshme

#### Shoqata Zvicerane e Pronës së Patundshme (SVIT)

[www.svit.ch](http://www.svit.ch), Telefon 044 434 78 88

### Sqarimi i dëmit

#### Specialistët për dëmtime strukturore dhe fizikë ndërtimore

Adresat mund t'i gjeni në faqet e verdha apo librin telefonik.

Firmat e specializuara për korrigjimin dhe kurimin kanë në dispozicion ekspertë të ndërtimeve dhe fizikes ndërtimore (shihni më poshtë).

Sektorët rajonalë të HEV dhe HVS u ofrojnë anëtarëve të tyre (me pagesë) një vlerësim profesional ndërtimor të ndërtesës së tyre (për adresën shihni më lart).

#### Shoqata Zvicerane e Suvatuesve dhe Bojaxhinjve

Kompani që punësojnë personel fiziko-ndërtimor, dhe mund t'i zbatojnë vetë sqarimet e dëmtimeve.

#### Shoqata e Termografisë Zvicër (theCH)


Me ndihmën e imazheve termike, bëhen të dukshme sipërfaqet e izoluara keq si dhe urat termike (Termografia). Kompanitë e shërbimit i gjeni në faqen: [www.thech.ch](http://www.thech.ch)

### Eliminimi i kërpudhave të mykut

Një eliminim profesional i kërpudhave të mykut pason sipas buletinit të Suva «Eliminimi i kërpudhave të mykut në hapësirat e brendshme» përkatësisht sipas buletinit të SMGV. Specifikimet në këto fletëpalosje i mbrojnë gjithashtu edhe banorët.


#### Kompanitë e specializuara për korrigjimin e kurimin

Në ato raste kur ka formim të madh të mykut, preferohen kompanitë e specializuara me aftësi ndërtimore dhe me përvojë në korrigjimet e kurimet e mëdha të mykut. Adresat: në faqet e verdha apo numërorin telefonik, me fjalë kyçe Korrigjimi e kurimi i dëmtimeve nga uji, fizika ndërtimore.



### Shoqata e Suvatuesve dhe Bojaxhinjve

Adresat: faqe e internetit <http://malergipser.com>, në faqet e verdha apo numërorin telefonik.



### Korrigjimi dhe kurimi i kërpudhave të mykut dhe restaurimi energjik i ndërtesës

Gjatë korrigjimeve e kurimeve të mëdha të kërpudhave të mykut ndoshta mund të kërkojnë shpenzime më të vogla me masa mbrojtëse me radon si dhe atyre për ruajtjen e energjisë.

Informacione rreth shërbimeve këshilluese mbi restaurimin energjik të ndërtesave japin organet kantonale dhe rajonale këshilluese energjetike si dhe ato profesionale energjetike.

Adresat: Faqe e internetit: [www.bfe.admin.ch / dienstleistungen](http://www.bfe.admin.ch/dienstleistungen) > *Dienstleistungen in meinem Kanton*

Informacione mbi radonin mund t'i gjeni në faqen: [www.ch-radon.ch](http://www.ch-radon.ch)

### Banimi dhe shëndeti

#### Agjencitë kantonale profesionale të lëndëve kimike

Këto organe janë përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit të lëndëve kimike dhe mund të këshillojnë njerëzit që kanë probleme me substanca të dëmshme në hapësirat e brendshme.

Adresa: [www.chemsuisse.ch](http://www.chemsuisse.ch)

#### Zyra Federale e Shëndetësisë, Fachstelle Wohngifte

Ky organ është i përkushtuar për përmirësimin e kushteve në lidhje me një jetesë më të shëndetshme dhe jep informacion mbi rreziqet nga substancat e dëmshme në hapësirën e brendshme. Ai nuk është përgjegjës rreth pyetjeve mbi ligjin e qiramarrjes.

Internet: [www.wohngifte.admin.ch](http://www.wohngifte.admin.ch)

E-Mail: [bag-chem@bag.admin.ch](mailto:bag-chem@bag.admin.ch), Tel. 031 322 96 40

